



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. 2-D/DPK	Br. Prot. 01-4769/15
Prot. No.	Data
Nr. i faq.	Datum
Broj stranica 02	Date 14.12.2015
Nr. pages	
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 11.12.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-4190-15 për z.Lulzim Kabashi–Nënkryetari i Komunës së Prizrenit, për shkak se janë shmangur situatat e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-4190-15, për Zyrtarin e lartë, z.Lulzim Kabash-Nënkryetar i Komunës së Prizrenit, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Kabashi është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës ai ka kontaktuar zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Kabashi është deklaruar se brenda afatit do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në biznes për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjell dy informata mbi bizneset (DPK/DPKI-03-02-4525/15), nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilat shihet se te bizneset individuale N.SH.“Sharri”, z.Bytyqi tashmë është hequr nga e drejta e të qenurit person i autorizuar, duke emëruar një person te besuar sikurse edhe te biznesi tjetër N.SH. ”LK Consulting”, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

